

## VENDIM

PANELI NR. 1

VENDIMI NR.: KPCC/D/A/42/2009  
DATA E VENDIMIT: 11/06/2009

## URDHËR

- (1) Në secilën prej 1,343 (një mijë e treqind e dyzet e tri) kërkesave të përmendura në pjesët A, B, C dhe D të Listës së bashkëngjitur, Komisioni

*vendos që*

*Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka dëshmuar pronësinë mbi pronën e kërkuar, apo mbi pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;*

- (2) Në secilën prej 946 (nëntë qind e dyzet e gjashtë) kërkesave të përmendura në pjesën D të Listës së bashkëngjitur, Komisioni

*vendos që*

*Paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar pronësinë e bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore mbi pronën e kërkuar, apo mbi pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;*

- (3) Në secilën prej 2,289 (dy mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë) kërkesave të përmendura në paragrafët (1) dhe (2) të mësipërm, përveç Kërkesave Nr. 56137, 56138, 37488, 21763, 38867, 36775, 33954, 33955, 33956, 54726 dhe 54727, Komisioni

*urdhëron që*

- (a) Paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, t'i jepet posedimi i pronës së kërkuar;

- (b) *Pala përgjegjëse dhe çdo person tjetër i cili ka uzurpuar pronën, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij urdhri; dhe*
- (c) *Nëse pala përgjegjëse apo çdo person tjetër i cili ka uzurpuar pronën dështon të përmbushë urdhrin për lirim të pronës brenda kohës së dhënë, ata do të dëbohen nga prona;*
- (4) *Në Kërkesat Nr. 06154, 06141, 11606, 37817, 35922, 35909 dhe 35910 ku prona e kërkuar është aktualisht e uzurpuar nga KFOR-i i cili gëzon imunitet nga procesi ligjor, Komisioni*  
*urdhëron që*
- (a) *Paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, t'i jepet posedimi i pronës së kërkuar pas lirimit të saj nga KFOR-i;*
- (b) *Çdo person tjetër që e ka uzurpuar pronën, përveç KFOR-it, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij urdhri; ose menjëherë pas lirimit të saj nga KFOR-i nëse kjo ndodh më vonë; dhe*
- (c) *Nëse çdo person tjetër që e ka uzurpuar pronën, përveç KFOR-it, dështon të përmbushë urdhrin për lirim të pronës brenda kohës së dhënë, ata do të dëbohen nga prona;*
- (5) *Në secilën kërkesë të përmendur në kolonat përkatëse në pjesët A, B, C, D dhe E të Listës së bashkëngjitur, Komisioni më tutje vendos që kërkesat të refuzohen për aq sa paraqitësi i kërkesës kërkon kompensim për dëmin material, apo humbjen e shfrytëzimit, të pronës së kërkuar; dhe*
- (6) *Në rastet kur ka më shumë se një pronar, vendimet dhe urdhri i mësipërm nuk ndikojnë në të drejtat e asnjërit nga bashkë-pronarët përkatës.*

## KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës ("Kuvendi") ka miratuar Ligjin Nr. 03/L-079 duke përshtatur dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 ("UNMIK/REG/2006/50") mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") duke përshtatur dhe ndryshuar Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut Nr. 2007/5 ("UNMIK/ADM/DIR/2007/5"), e cila zbaton UNMIK/REG/2006/50. Ligji Nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë themeluar Agjencinë Kosovare të Pronës ("KPA") si agjenci të pavarur sipas Nenit 142 të Kushtetutës së Kosovës, dhe kanë ndryshuar dispozitat përkatëse të UNMIK/REG/2006/50 dhe UNMIK/ADM/DIR/2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me kriteret e tyre, Ligji Nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

2. Sipas nenit 22 të UNMIK/REG/2006/50, Rregullorja pushon së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji Nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të

Komisionit. Dispozitat e UNMIK/REG/2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit Nr. 03/L-079

3. Sipas Nenit 10-të të Ligjit Nr. 03/L-079, i cili ka ndryshuar nenin 7.1 të UNMIK/REG/2006/50, Komisioni për Kërkesa Pronësore ("Komisioni") duhet të emërohet nga Kuvendi me nominim nga Kryetari i Gjykatës Supreme, me kusht që deri në përfundim të mbikëqyrjes ndërkombëtare mbi zbatimin e Propozimit Gjithëpërfshirës të Marrëveshjes për Statusin e Kosovës të datës 26 mars 2007, dy nga tre anëtarët, përfshirë Kryetarin, duhet të emërohen nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar. Dy anëtarët ndërkombëtarë të Komisionit janë emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar me vendimin e datës 6 mars 2009. Komisioneri vendor është emëruar me vendimin e Kuvendit të datës 12 mars 2009.

4. Nga ajo që u tha më sipër, Komisioni konsideron se është i caktuar sipas rregullave dhe është kompetent të ushtrojë funksionin e vet sipas Ligjit Nr. 03/L-079, si dhe urdhëresave dhe legjislacionit relevant për zbatim.

### ARSYET PËR VENDIMIN

5. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejtë të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshinë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079.)

6. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079.)<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi I kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksat e saj, Neni 26 i Aneksit I parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksat e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri

7. Komisioni ka mbajtur seancën e tij të dymbëdhjetë prej 8-11 qershor 2009 në Prishtinë. Gjithsejt 2,370 kërkesa për pronë bujqësore i ishin paraqitur Komisionit në seancën e tij të dymbëdhjetë, nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ("Sekretaria Ekzekutive"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata tjera relevante.

8. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe i ka raportuar mbi përpunimin e kërkesave, dhe çështjet ligjore dhe dëshmuere të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

#### *A. Kërkesat për pronësi*

9. Në të gjitha kërkesat që përfshihen në këtë vendim, paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesave mbi pronësinë, dhe të gjitha kanë të bëjnë me pronë bujqësore, përfshirë arën, kullosën dhe pyjet. Në bazë të shqyrtimit të kërkesave dhe dokumentacionit mbështetës, informatave të ofruara dhe verifikimit të bërë nga Sekretaria Ekzekutive, gjithsejt 45 kërkesa i janë kthyer Sekretarisë Ekzekutive nga Komisioni për shqyrtim dhe verifikim shtesë, ose janë tërhequr nga Sekretaria Ekzekutive. Këto kërkesa të cilat janë regjistruar në pjesën F ("Kërkesa të kthyer") dhe në pjesën G ("Kërkesa të tërhequra") të Listës së bashkëngjitur do të shqyrtohen nga Komisioni në kohën e duhur. Gjatë seancës, një kërkesë për pronë banesore është ri-kategorizuar si kërkesë për pronë bujqësore, ndërsa një kërkesë për pronë bujqësore është ri-kategorizuar si kërkesë për pronë komerciale. Ky vendim aplikohet për 2,289 kërkesa të cilat janë regjistruar në pjesët A, B, C, D dhe E të Listës së bashkëngjitur. 30 kërkesat tjera për pronë bujqësore, të cilat janë refuzuar nga Komisioni, përfshihen në vendimin KPCC/D/A/43/2009. Gjashtë kërkesat e mbetura për pronë bujqësore përfshihen në vendimin KPCC/D/A/44/2009 (tri kërkesa kontestuese) dhe në vendimin KPCC/D/A/45/2009 (tri kërkesa mbi të drejtën e shfrytëzimit)

10. Komisioni cek se të gjitha kërkesat e regjistruara në pjesët A, B, C, D dhe E të Listës së bashkëngjitur janë jokontestuese në kuptimin se në kohën e notifikimit të pronave të kërkuara nuk ka pasur dëshmi të uzurpimit të paligjshëm, shfrytëzimit apo kultivimit të këtyre pronave nga ndonjë person apo, edhe ku ka pasur dëshmi të tilla, asnjë palë nuk e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30-ditësh të paraparë në nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të përshtatur në Ligjin Nr.03/L-079, e as më vonë gjatë përpunimit, sipas nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të përshtatur në Ligjin Nr.03/L-079. Bazuar në informatat e ofruara nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni është i kënaqur që Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje të arsyeshme për të notifikuar pronat e kërkuara, personat të cilët aktualisht mund të kenë uzurpuar pronat, dhe çdo person tjetër që mund të ketë ndonjë interes ligjor në pronat e tilla, siç kërkohet nga neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të përshtatur në Ligjin Nr.03/L-079. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të konsiderohen jokontestuese.

11. Në të gjitha kërkesat e përmendura në pjesët A, B, C, D dhe E të Listës së bashkëngjitur, Komisioni vëren se paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur lloje të ndryshme të dokumenteve në mbështetje të kërkesave të tyre mbi pronësinë duke përfshirë fletat poseduese, kontratat e

---

Aneksat e Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislativë dhe Komisioni do t'u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksat I, II dhe III, respektivisht.

shitblerjes, kontratat mbi dhurimin, kontratat mbi ndarjen e pronës, vendimet e trashëgimisë, vendimet e gjykatës që njohin pronësinë, kontratat mbi përkujdesjen jetësore, dhe certifikatat mbi të drejtën e paluajtshmërisë. Komisioni është i kënaqur që të gjitha këto dokumente përbëjnë dëshmi të pronësisë. Të gjitha këto dokumente janë vërtetuar nga Sekretaria Ekzekutive si valide. Shumë paraqitës të kërkesave kanë paraqitur gjithashtu dokumente mbështetëse plotësuese, përfshirë vendimet mbi tatimin, deklaratat e dëshmitarëve, kopjet e planeve dhe vendimet kadastrale.

12. Në 618 kërkesat e përmendura në pjesën A të Listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Duke marrë parasysh ato që ka konstatuar Komisioni në paragrafin 11 të mësipërm, të gjitha këto kërkesa qëndrojnë të aprovohen. Në Kërkesën Nr. 24977, bartësi i së drejtës pronësore pohon se ka ndërtuar një shtëpi në pronën e tij në vitin 1950. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive nuk ka gjetur asnjë dëshmi të ndonjë shtëpie as në fletën poseduese e as gjatë notifikimit fizik të pronës. Rrjedhimisht, Komisioni ka shqyrtuar dhe ka zgjidhur kërkesën si kërkesë për pronë bujqësore.

13. Në 449 kërkesat e përmendura në pjesën B të Listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore në pajtim me nenin 1.2 të Aneksit II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079. Neni 1 i Udhëzimit Administrativ të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079 përcakton që si “Anëtar i Bashkësisë Familjare” përfshihet “bashkëshorti/ja, fëmijët (të lindur brenda dhe jashtë martese apo të adoptuar) dhe personat tjerë të cilët bartësi i së drejtës pronësore është i obliguar t’i mbështesë në pajtim me ligjin e aplikueshëm, apo personat të cilët janë të obliguar të mbështesin bartësin e së drejtës pronësore në pajtim me ligjin e aplikueshëm, pavarësisht nëse ata persona kanë apo nuk kanë banuar në pronë së bashku me bartësin e së drejtës pronësore.” Komisioni ka përcaktuar se, sipas ligjit të aplikueshëm, ky definicion përfshinë përveç bashkëshortëve dhe fëmijëve, gjithashtu edhe prindërit, vëllezërit, motrat, gjyshërit dhe nipat/mbesat e bartësit të së drejtës pronësore. Të gjithë paraqitësit e kërkesave në kërkesat e përmendura në pjesën B të Listës së bashkëngjitur përfshihen në definicion e anëtarit të bashkësisë familjare. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të së drejtës pronësore qëndron të aprovohet në secilën kërkesë të përmendur në pjesën B të Listës së bashkëngjitur, siç është dhënë më sipër. Në kërkesat e përmendura në shtyllën përkatëse të pjesës B të Listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës pohon se bartësi i së drejtës pronësore ka vdekur por nuk është paraqitur dëshmi e pranueshme nga paraqitësi i kërkesës e cila do ta dëshmonte vdekjen, dhe as Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të gjejë ndonjë dokument të tillë. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të së drejtës pronësore gjithashtu qëndron të aprovohet në secilën nga këto kërkesa, siç është dhënë më sipër.

14. Në 11 kërkesat e përmendura në pjesën C të Listës së bashkëngjitur, bartësit e së drejtës pronësore përfaqësohen nga persona fizikë të autorizuar që posedojnë autorizim. Komisioni ka përcaktuar se në secilin nga këto raste, personi fizik i autorizuar posedon autorizim valid dhe të zbatueshëm sipas nenit 5.2 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të së drejtës pronësore gjithashtu qëndron të aprovohet në secilën nga këto kërkesa, siç është dhënë më sipër.

15. Në 265 kërkesat e përmendura në pjesën D të listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës apo bartësi aktual i të drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, nuk ishte bartës i së drejtës pronësore në datën e humbjes së posedimit të pronës së kërkuar, por ka ofruar dëshmi që më

vonë e ka trashëguar të drejtën përkatëse të pronësisë përmes trashëgimisë, kontratës mbi dhurimin apo kontratës mbi shitblerjen, siç mund të jetë rasti. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi aktual i të drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, duhet të konsiderohet si person i cili ka trashëguar të gjitha të drejtat që i takojnë një pronari, përfshirë të drejtën për të kërkuar konfirmimin e pronësisë dhe për riposedit në procedurat aktuale. Prandaj, këto kërkesa qëndrojnë të aprovohen, siç është dhënë më sipër. Në kërkesat e përmendura në shtyllën përkatëse të kësaj pjese C të listës së bashkëngjitur, kërkesat janë paraqitur ose nga anëtar i bashkësisë familjare ose nga përfaqësuesi i autorizuar që vepron në emër të bartësit të së drejtës pronësore. Komisioni përcakton se paraqitësit e kërkesave në këto raste janë ose anëtarë të bashkësisë familjare të bartësit aktual të së drejtës pronësore në kuptim të nenit 1 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079 ose janë bartës aktual të së drejtës pronësore të cilët kanë autorizuar përfaqësues me autorizim valid dhe të zbatueshëm sipas nenit 5.2 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079, të paraqesin kërkesë në emër të tyre. Kërkesa Nr.28279 është paraqitur nga bashkëshortja e bartësit të së drejtës pronësore si anëtare e bashkësisë familjare. Edhe pse paraqitësi i kërkesës pohon se Bartësi i së Drejtës pronësore ka vdekur, nuk është paraqitur asnjë dëshmi për t'a mbështetur këtë fakt dhe pronësia qëndron të aprovohet në emër të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore.

16. Në 946 kërkesat e përmendura në pjesën E të Listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës nuk ishte bartës i së drejtës pronësore në datën e humbjes së posedimit të pronës së kërkuar, por pohon të ketë trashëguar pronën. Në kërkesën Nr. 07507 paraqitësi i kërkesës është bashkëshortja e bartësit të të ndjerë të së drejtës pronësore i cili të drejtën e tij mbi pronën e ka fituar pas vdekjes së nënës së tij e cila ishte bartëse e së drejtës pronësore në datën e humbjes së posedimit të pronës në vitin 1999. Në secilën nga këto kërkesa, paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar se ai apo ajo është anëtar i bashkësisë familjare të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore. Megjithatë, nuk është paraqitur vendim valid mbi trashëgiminë apo ndonjë dëshmi tjetër e dokumentuese nga paraqitësit e kërkesave që do të vërtetonte se ndonjëri nga paraqitësit e kërkesave është trashëgimtar i pronës së kërkuar dhe as Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të gjejë ndonjë dokument të tillë. Disa paraqitës të kërkesave kanë paraqitur si dëshmi "vendimet e trashëgimisë" për këtë qëllim nga gjykatat paralele në Serbi. Komisioni nuk konsideron se dokumentet e tilla vërtetojnë të drejtën e trashëgimisë. Komisioni nuk ka jurisdiksion të zgjidhë çështjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore në secilën nga këto kërkesa qëndron të aprovohet, siç është dhënë më sipër. Vendimi i Komisionit sa u përket të gjitha kërkesave të përmendura në këtë pjesën E të listës së bashkëngjitur është pa paragjykim ndaj përcaktimit nga gjykata kompetente se si trashëgimtarët do të trashëgojnë të drejtën pronësore nga i ndjeri. Në kërkesat e përmendura në shtyllën përkatëse të kësaj pjese E të Listës së bashkëngjitur, anëtar i bashkësisë familjare të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore është përfaqësuar nga personi i autorizuar fizik i cili posedon autorizim. Komisioni përcakton se në secilën nga këto raste personi i autorizuar fizik posedon autorizim të vlefshëm dhe të zbatueshëm nga anëtar i bashkësisë familjare i bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore sipas nenit 5.2 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore qëndron të aprovohet në secilën nga këto raste.

17. Llojet e ndryshme të dokumenteve në të cilat mbështeten paraqitësit e kërkesave në përkrahje të kërkesave të cilat përmenden në paragrafët 12, 13, 14, 15 dhe 16 të mësipërm, janë të regjistruar në shtyllat përkatëse të pjesëve A, B, C, D dhe E të Listës së bashkëngjitur.

18. Në një numër kërkesash paraqitësit e kërkesave apo bartësit e së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, janë larguar nga prona jashtë periudhës 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999, e cila parashihet në nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079. Komisioni ka përcaktuar se, ndonëse data e largimit në këto kërkesa është jashtë periudhës së mësipërme, humbja e së drejtës pronësore në secilin rast është rezultat i rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, siç parashihet me nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079. Në Kërkesat Nr.10249, 35454 dhe 35455, bartësit e së drejtës pronësore në kohën përkatëse, i kanë lëshuar pronat e tyre si pasojë e trazirave ndër-etnike që kanë ndodhur në Kosovë në mars 2004. Komisioni konsideron se këto humbje të pronësisë janë të ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes viteve 1998 dhe 1999.

19. Në Kërkesat Nr. 56137, 56138, 37488, 21763, 38867, 36775, 33954, 33955, 33956, 54726 dhe 54727 (të regjistruara në shtyllën përkatëse të Listës së bashkëngjitur), Paraqitësit e kërkesave kërkojnë konfirmimin e të drejtës së tyre të pronësisë mbi pronat e kërkuara pa urdhër për dëbim pasi që i është dhënë leje për të shfrytëzuar pronën e kërkuar një personi të caktuar. Në këto rrethana, urdhri i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, qëndron të aprovohet, pa ndonjë formë tjetër të ndihmës juridike, siç është dhënë më sipër.

20. Në Kërkesat Nr 06154, 06141, 11606, 37817, 35922, 35909 dhe 35910, pronat e kërkuara janë aktualisht të uzurpuara nga KFOR-i i cili sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/47 gëzon imunitet ndaj proceseve ligjore. Komisioni konsideron se këto kërkesa, për aq sa ata kërkojnë konfirmimin e pronësisë, janë *in rem* ashtu që rrjedhimisht aprovimi i tyre nuk shkel imunitetin të cilin e gëzon KFOR-i. Sekretaria Ekzekutive jozyrtarisht është konsultuar me KFOR-in, i cili, me sa duket, nuk pajtohet me këtë qasje. Megjithatë, imuniteti të cilin e gëzon KFOR-i e pengon Komisionin të lëshojë urdhër për dëbim kundër KFOR-it si uzurpues aktual i pronave të kërkuara. Rrjedhimisht, urdhri për dëbim në rastet e mësipërme aplikohet vetëm tek palët e treta të cilat në mënyrë të paligjshme mund të uzurpojnë pronat e kërkuara pas lirimit të tyre nga KFOR-i.

21. Në disa raste, paraqitësi i kërkesës ka vdekur pasi që ka paraqitur kërkesën. Komisioni konsideron se vdekja e paraqitësit të kërkesës gjatë procesit nuk mund të ndikojë në vlefshmërinë e kërkesës. Rrjedhimisht, vendimi që konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të së drejtës pronësore qëndron të aprovohet, siç është cekur më lart. Vendimi është pa paragjykim ndaj përcaktimit nga gjykata kompetente se si trashëgimtarët do të trashëgojnë të drejtën pronësore nga i ndjeri. Kërkesat në të cilat paraqitësit e kërkesave kanë vdekur gjatë procesit janë regjistruar në shtyllat përkatëse të pjesëve A, B, C, D dhe E të Listës së bashkëngjitur.

22. Duke pasur parasysh të mësipërmen, Komisioni është i kënaqur, bazuar në dëshmitë që i posedon, që:

- (a) qitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka pasur të drejtën e pronësisë mbi pronën e kërkuar, apo mbi pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;
- (b) secila kërkesë është e pakontestuar në kuptimin se asnjë person nuk e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës;

- (c) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, në secilin rast tani nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij apo të saj të pronësisë; dhe
- (d) secila kërkesë në secilin rast përfshinë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

*B. Kërkesat për kompensim*

23. Në kërkesat e përmendura në shtyllat përkatëse të pjesëve A, B, C, D dhe E të Listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesave, përveç pronësisë gjithashtu kërkojnë kompensim për dëmin material, apo humbje të shfrytëzimit, të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka jurisdiksion mbi kërkesat e tilla. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të refuzohen.

*C. Vërejtje përmbledhëse*

24. Nga ajo që u tha më sipër, Komisioni konstaton se kërkesat e përmendura në pjesët A, B, C, D dhe E të Listës së bashkëngjitur janë të suksesshme dhe urdhri, sa i përket secilës kërkesë, të jepet siç është dhënë më sipër.

25. Në një numër kërkesash, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë për riposëdim të pronës së njëjtë edhe në Drejtoratin për Çështje Pronësore dhe Banesore, e cila kërkesë pastaj ishte aprovuar nga Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore ("HPCC"). Komisioni konstaton se mjetet e veprimit në dispozicion të paraqitësve të kërkesave para Komisionit aktual dhe HPCC-së, respektivisht, dhe rrjedhimisht edhe jurisdiksioni i dy Komisioneve, nuk janë të njëjta në kuptimin se, ndryshe nga HPCC-ja, Komisioni aktual ka jurisdiksion për të konfirmuar pronësinë. Prandaj, vendimet e HPCC-së nuk mund të përbëjnë *res judicata* para Komisionit aktual. Për më tepër, në rastet kur HPCC-ja ka aprovuar urdhrin për dëbim në favor të paraqitësit të kërkesës, Komisioni nuk konsideron se një urdhër i tillë paraqet pengesë për këtë Komision që të lëshojë urdhër të ri për dëbim në rastet kur prona është e uzurpuar në mënyrë të paligjshme.

26. Vendimi dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe në çdo pronë të bashkuar *d.m.th.* çdo ndërtesë apo ndërtime të tjera të zotëruara apo shfrytëzuara nga paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

27. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079, lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i madh. Komisioni konsideron se kjo është e përshtatshme në rastin konkret.



Kryetari



### ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

**\* Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze.**

Spreadsheet /Lista /Prilog  
Part A/Pjesa A/Deo A

|          |          |          |          |          |          |          |
|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|
| KPA01216 | KPA06899 | KPA06902 | KPA06910 | KPA06913 | KPA08137 | KPA10694 |
| KPA11249 | KPA15115 | KPA15465 | KPA18317 | KPA32285 | KPA39756 | KPA39757 |
| KPA39760 | KPA40635 | KPA40636 | KPA40639 | KPA47761 | KPA54224 | KPA01236 |
| KPA01237 | KPA19290 | KPA25657 | KPA34460 | KPA34462 | KPA34463 | KPA34464 |
| KPA34465 | KPA34466 | KPA34467 | KPA34468 | KPA34470 | KPA37187 | KPA37189 |
| KPA37190 | KPA42407 | KPA48837 | KPA50149 | KPA53135 | KPA10648 | KPA10650 |
| KPA10651 | KPA10652 | KPA23328 | KPA28414 | KPA28573 | KPA28574 | KPA29966 |
| KPA31296 | KPA31426 | KPA31429 | KPA35441 | KPA35443 | KPA35969 | KPA35973 |
| KPA37188 | KPA48639 | KPA48641 | KPA48642 | KPA00658 | KPA11181 | KPA11183 |
| KPA11317 | KPA23545 | KPA28569 | KPA28570 | KPA28571 | KPA33118 | KPA33132 |
| KPA37296 | KPA38349 | KPA38809 | KPA48827 | KPA48835 | KPA50494 | KPA50499 |
| KPA50946 | KPA53134 | KPA53136 | KPA10711 | KPA10712 | KPA10713 | KPA10718 |
| KPA14146 | KPA14684 | KPA19340 | KPA21787 | KPA21789 | KPA22808 | KPA27306 |
| KPA32276 | KPA34461 | KPA38952 | KPA49056 | KPA49057 | KPA49064 | KPA50891 |
| KPA50896 | KPA54742 | KPA01007 | KPA07878 | KPA10524 | KPA11025 | KPA11180 |
| KPA11182 | KPA11184 | KPA11185 | KPA11215 | KPA14828 | KPA15172 | KPA27119 |
| KPA31298 | KPA34047 | KPA41088 | KPA43283 | KPA47254 | KPA47714 | KPA50594 |
| KPA53013 | KPA01047 | KPA06652 | KPA10710 | KPA10716 | KPA10717 | KPA23096 |
| KPA23402 | KPA24082 | KPA24218 | KPA24977 | KPA32282 | KPA40238 | KPA40284 |
| KPA40724 | KPA47762 | KPA49038 | KPA50894 | KPA53010 | KPA53071 | KPA54218 |
| KPA01238 | KPA01239 | KPA01240 | KPA08622 | KPA22088 | KPA22524 | KPA25280 |
| KPA32269 | KPA34086 | KPA35837 | KPA40285 | KPA41416 | KPA41472 | KPA42020 |
| KPA47250 | KPA48026 | KPA49120 | KPA51735 | KPA54134 | KPA54214 | KPA00621 |
| KPA01235 | KPA01411 | KPA11132 | KPA23050 | KPA23237 | KPA27658 | KPA27661 |
| KPA33764 | KPA38053 | KPA38807 | KPA42408 | KPA43381 | KPA47951 | KPA49044 |
| KPA49604 | KPA50360 | KPA50495 | KPA53132 | KPA53898 | KPA06845 | KPA07694 |
| KPA13318 | KPA13319 | KPA22564 | KPA22567 | KPA22927 | KPA22929 | KPA34422 |
| KPA37399 | KPA37400 | KPA37402 | KPA44192 | KPA45219 | KPA49188 | KPA52655 |
| KPA53844 | KPA53845 | KPA53849 | KPA54544 | KPA18030 | KPA23118 | KPA23339 |
| KPA23340 | KPA23342 | KPA23552 | KPA27747 | KPA27763 | KPA35251 | KPA35254 |
| KPA35440 | KPA36247 | KPA38275 | KPA39250 | KPA41407 | KPA41410 | KPA41411 |
| KPA53733 | KPA53734 | KPA15466 | KPA16245 | KPA23227 | KPA23228 | KPA23229 |
| KPA23716 | KPA26129 | KPA26130 | KPA26131 | KPA26132 | KPA27793 | KPA31744 |
| KPA34319 | KPA38565 | KPA41518 | KPA47847 | KPA48866 | KPA50810 | KPA50811 |
| KPA53729 | KPA20035 | KPA26262 | KPA29873 | KPA31997 | KPA36233 | KPA36439 |
| KPA39761 | KPA40545 | KPA41079 | KPA41275 | KPA41276 | KPA48994 | KPA53794 |
| KPA54739 | KPA56534 | KPA07262 | KPA14164 | KPA17090 | KPA17849 | KPA18234 |
| KPA19299 | KPA19302 | KPA22818 | KPA23401 | KPA26299 | KPA27046 | KPA27047 |
| KPA27664 | KPA31522 | KPA36783 | KPA49315 | KPA50614 | KPA50615 | KPA50616 |
| KPA50662 | KPA00433 | KPA06883 | KPA08022 | KPA08912 | KPA21646 | KPA24266 |

|          |          |          |          |          |          |          |
|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|
| KPA26291 | KPA26292 | KPA26482 | KPA32133 | KPA47074 | KPA47711 | KPA49555 |
| KPA50294 | KPA50657 | KPA50659 | KPA54592 | KPA56137 | KPA56138 | KPA56778 |
| KPA00848 | KPA00849 | KPA00851 | KPA00853 | KPA10138 | KPA22400 | KPA23905 |
| KPA25867 | KPA25919 | KPA26683 | KPA28401 | KPA34164 | KPA35834 | KPA40074 |
| KPA40076 | KPA40077 | KPA40079 | KPA45222 | KPA08850 | KPA08969 | KPA13304 |
| KPA17061 | KPA21745 | KPA21747 | KPA23166 | KPA27589 | KPA32419 | KPA35494 |
| KPA36786 | KPA37294 | KPA40071 | KPA40075 | KPA41035 | KPA45207 | KPA45478 |
| KPA46233 | KPA52585 | KPA54516 | KPA00852 | KPA37186 | KPA37295 | KPA38701 |
| KPA39085 | KPA44909 | KPA46130 | KPA50665 | KPA50854 | KPA52319 | KPA52324 |
| KPA52325 | KPA52326 | KPA52333 | KPA52335 | KPA52337 | KPA52338 | KPA52340 |
| KPA52342 | KPA52346 | KPA00617 | KPA11105 | KPA22069 | KPA33470 | KPA34165 |
